

Karta e-Parë e apostollit Pavël mbë Timothenë.

Krye 1.

- 1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit, pas urdhërit të Perëndisë, shpëtimtarit t'ënë, edhe të
- 2 Zotit Jisu Krisht, shpresësë s'onë, Mbë Timothenë, të-thjeshtinë djalë mbë besët, *qoftë* hir, përdëllim, paqtim, prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.
- 3 Sikundrë t'uluçë, kur vinja për ndër Maqedhoni, të preç ndër Efesë, që të porosiç ca
- 4 veta të mos mësonjënë mësimë të-tjerë, As të mos u vënë vesh përrallave e brezave që s'kanë të-mbaruarë, të-cilatë bjenë qarta më tepërë se të-ndërtuarë ndër besët të Perëndisë, *kështu bëj*.
- 5 Edhe fundi i porosisë është dashuri prej zemëre së-kthjellëtë, edhe prej ndërgjegjeje
- 6 së-mirë, edhe prej bese pa ipokrisi; Prej të-cilavet *ca veta* ularguanë e ukthyenë ndër fjaltë të-kota, Dyke dashurë të jenë nom-mësonjës, ndonëse s' kupëtonjënë as ato që thonë,
- 8 as ato që i bënë për të-vërteta. Edhe e dimë, se nomi *është* i-mirë, ndër qoftë se e
- 9 përndor atë njeriu me udhe, Dyke diturë këtë, se nomi nuk' është vënë për të-drejtinë, po për të-paudhët' e për të-pabinduritë, për ata që s'druanjënë *Perëdinë* e për fajtorëtë, për

- të-shtrëmbërit' e për të-ndyrëtë, për atëvra-
 10 sësit' e mëmëvrasësitë, për njerivrasësitë, Për kurvarëtë, për ata që bjenë me meshkuj, për ata që shesënë njerës, për gënjeshtarëtë, për ata që shkelnjënë benë, edhe për ç'do gjë tjetërë që i del kundrë mësimit të-shëndoshë,
 11 Pas ungjillit të lavdis' së të-lumurit Perëndi, që m'u besua mua.
 12 Edhe i falem ndersë Jisu Krishtit, Zotit t' ënë, që më dha fuqi, se më numëroj për besë-
 13 tar, e më vuri ndë shërbesët mua, Që më përpara ishnja vllasfimitar, e ndjekës e sharanik; po upërdëlllyeshë, sepse pa diturë i bëra ndë
 14 pabesëri; Edhe hiri i Zotit t' ënë tepëroj *mbë mua* me besë e me dashuri që është mbë Jisu
 15 Krishtinë. Për të zënë besë është fjala edhe e-vëjyerë për të priturë, se Jisu Krishti erdhi në botët që të shpëtonjë fajtorë, prej të-
 16 cilëvet i-pari jam unë; Po përëndaj upërdëlllyeshë, që të dëftenjë Jisu Krishti më përpara tek unë gjithë zëmëren' e-gjerë, për shëmbëllë mbë ata që i kanë për të besuarë
 17 ati për jetë të-përjetëshme. Edhe mbë mbretin' e jetëvet, të-pavdjerinë, të-padukurinë, të-vetëminë (të-diturë) Perëndi, *qoftë* nder edhe lavdi ndë jetët të jetëvet. Amin.
 18 Këtë porosi po të lë ndë dorë tyj, o bir Timothe, pas profitivet që ufolnë më përpara për ty, të luftonjë pas atyreve luftën' e mirë, Dyke pasurë besë edhe ndërgjegje të-

mirë, të-cilënë ca dyke hedhurë tej ranë ja-shtë nga besa; Prej këtyreve është Ymeneu edhe Aleksandri, të-cilëtë i kam dhënë ndë dorët të Satanajt, që të-mësonenë të mos vllasfimisnjënë.

Krye 2.

- 1 Lutem pra më përpara nga të-gjitha të bënë të-lutura, të-falura, të-folura, të-falura ndersë, për gjithë njerëzitë, Për mbretër, për gjithë sa janë mbë shkallë të-lartë, që të shkojmë jetë të-qel' e të-siguarë me çdo
- 3 perëndi-ndrojtje e mënyrë të-hieshime. Sepse këjo *është* e-mir' edh'e-pëlqyerë përpara Pe-
- 4 rëndisë, shpëtimtarit t' ënë, I-cili do të shpëtonjë gjithë njerëzitë, edhe të vinjënë ndë të-njohurit të së-vërtetësë. Sepse një është Pe-
- 5 rëndia, një *është* edhe mesësi ndër mest të-Perëndisë edhe të njerësve, njeriu Jisu Krisht,
- 6 Që dha vetëhen' e ti çpërblim për të-gjithë,
- 7 për dëshmim ndë kohëra të-urdhëruara, Për të-cilinë *dëshmim* uvushë unë lëçitës edhe apostoll, (të-vërtetënë them mbë Krishtinë, nukë gënjenj,) mësonjës i kombevet ndë besët edhe ndë të-vërtetët.
- 8 Dua pra burratë të falenë mbë çdo vënt, dyke ngriturë duar të pastrëta, pa zëmërim
- 9 e pa dyshim. Gjithashtu edhe gratë letë stolisnjënë vetëhen' e tyre me rrobë të-hieshime, me turp e me urtësi, jo me gërsheta, a me

ar, a me margaritarë, a me rroba shumë të-
10 vëjyera; Po me punëra të-mira, (e-cila gjë
u ka hie atyre grave që tregonen për pe-
11 rëndindruanjëse). Gruaja letë mësonetë ndë
12 pushim me çdo farë të-binduri; Sepse gru-
asë nuk' i ap lejë të mësonjë të-tjerë, as
13 të jetë zot mbi burrinë, po të pushonjë. Se-
14 pse përpara ugatua Adhami, pastaj Eva. E-
dhe Adhami nuk' uqënje, po gruaja uqënje
15 e doli jasht' udhësë; Po dotë spëtonjë me
anë të të-pjellit fëmijë, ndë qoftë se këta
qëndronjënë ndë besët e ndë dashurit e ndë
shënjtërimt me urtësi.

Krye 3.

1 Për të zënë besë është fjala; Ndë dëshë-
ron ndonjë të bënet' episkop, punë të-mi-
2 rë dëshëron. Duhetë pra episkopi të jetë i-
pazënë ndë faj, burrë i një gruaje, vetë-për-
mbanjës, i-urtë, i-hieshim, huaj-pritës, i-zoti
3 të mësonjë *nyerëzitetë*; Jo pianik, jo grindës,
(jo i-dhënë pas fitimi të-keq); po i-butë, *njeri*
që s' do të zihetë, *njeri* që s' lakmon për
4 ergjënt; *Njeri* qe qivernis mirë shtëpin' e ti,
që ka fëmijë të-bindurë me çdo farë urtë-
5 sie; (Sepse ndë qoftë se ndonjë nukë di të
qivernisnjë shtëpin' e ti, qysh dotë kujdesetë
6 për kishën' e Perëndisë?) Të mos jetë më-
suarë rishtazi *ndë besët*, që të mos fryhetë
me madhështi e të bjerë ndë dënimt të dja-

7 lit. Duhetë edhe të ketë dëshmim të-mirë
edhe nga të-jashtësmitë që të mos bjerë ndë
turp e ndë lakt të djallit.

8 Dhjakëritë gjithashtu, *duhetë të jenë* të-
hieshim, jo me dy faqe ndë fjalët, jo të-dhë-
nurë ndë shumë verë, jo të-rënë pas fitimi
9 të-lik; Të kenë fshehësirën'e besësë me ndër-
10 gjegje të-kthjellëtë. Edhe këta letë provone-
në më parë, e pastaj letë bënenë dhjakër, ndë
qoftë se nukë hiqenë ndëpër gojë për fajtorë.
11 Grat'e tyre gjithashtu *të jenë* të-hieshime, jo
kallzimtare, vete-përmbanjëse, besëtare mbë
12 të-gjitha. Dhjakëritë letë jenë burra të një
gruaje, edhe asish që qiverisnjënë mirë fëmi-
13 jën' e tyre e shtëpit' e tyre Sepse ata që kanë
shërbyerë mirë, fitonjënë shkallë të-mirë për
vetëhen' e tyre, edhe shumë kuxim ndë be-
sët që është mbë Jisu Krishtinë.

14 Këto po të shkruanj, dyke shpëryerë të
15 vinj për-së-çpejti te ti; Po ndë mënofsha, që
të dish si duhetë të sillesh ndë shtëpit të Pe-
rëndisë, e-cila është kisha e Perëndisë' së-
gjallë, shtylla edhe pshtetja e së-vërtetësë.

16 Edhe pa kundrëfjalë e-madhe është fshe-
hësira e besësë; Perëndia uçaq ndë mish,
doli i-drejtë ndë Frymët, uduk nd' ëngjëj, u-
lëçit ndër kombe, uzu besë ndë botët, hipi
lart me lavdi.

Krye 4.

- 1 Edhe Fryma çfaqurë thotë, se ndë kohëra të-pastajme dotë ngrënë krye ca *veta* nga besa, e dot' u mbanjënë vesh frymave gënjeshtare, edhe mësimëve djajsh, Qe flasënë gënjeshtre me ipokrisi, që kanë ndërgjegjen'
- 2 e tyre të-djegurë, Të-cilëtë ndalonjënë martesënë, e *urdhëronjënë* të largonenë *besëtarëtë* nga të-ngrëna, të-cilatë Perëndia i ka kriuarë, që t' i marrënjë me të-falurë nder-së besëtarëtë edhe ata që kanë njohurë të-vertetënjë. Sepse çdo kriesë e Perëndisë *është* e-mirë, edhe nukë ka gjë për të hedhurë tej,
- 3 po të merretë me të-falurë ndersë; Sepse shënjtëronetë me fjalën' e Perëndisë e me të-faluritë.
- 4 Ndë u sjellç ndër mëntt vëllezërvet këto, dotë jesh shërbëtuar i-mirë i Jisu Krishtit, i-ushqyerë me fjalët' e besësë, edhe me
- 5 mësimn' e-mirë, qe i ke rënë pas. Edhe prej fjalëvet të-ndyra edhe të plakavet hiq dorë, edhe stërvit vetëhenë t' ende ndë besët të-
- 6 mirë. Sepse të-stërviturit' e trupit është të-dobishim për pak kohë; po besa e-mirë së-gjithash është e-dobishime, sepse ka të-zotuarë për këtë jetë ndashti edhe për atë që
- 7 ka për të ardhurë. Për të zënë besë është fjala edhe e-vëjyerë për të-priturë *të-mirë*.
- 8 Sepse për këtë edhe mundonemi edhe përbu-

- zemi, sepse shpëryemë mbë të-gjallinë Perëndi, i-cili është shpëtimtari i gjithë njerësvet, po më fort i besëtarëvet. — Porosit këto edhe mëso.
- 9 Asndonjë letë mos të hethnjë poshtë për të-ritë t'ënt, po bënu shëmbëllë e besëtarëvet ndë fjalë, ndë të-shoqëruarë, ndë dashuri, (ndë frymë,) ndë besë, ndë *zëmërë* të-qëruarë. Gjersa të vinj, epu pas të-kënduarit, pas të-këshilluarit, pas të-mësuarit. Mos
 - 10 hij i-pakujdesurë për dhurëtinë që është te ti, e-cila t'udha me të profitie, me të vënit'
 - 11 eduarvet të pleqësisë *mbë ty*. Mbë këto kujdesu, mbë këto qëndro, që të jetë e-çfaqurë mbarësia jote mbë të-gjithë. Ruaj vetëhenë t'ende edhe mësimnë; qëndro mb' ato. Sepse ndë bësh këtë, edhe vetëhenë t'ende dotë shpëtonjç, edhe ata që të dëgjonjënë ty.

Krye 5.

- 1 Plakunë mos e qërto, po mëso-e posi atë; të-rinjte, posi vëllezër; Plakatë, posi mëma; të-ratë, posi motëra, me çdo *zëmërë* të-qëruarë.
- 2 *Grat'* e-va ndero-i, ato që janë me të-vërtetë të-va. Edhe ndë ka ndonjë e-ve djem a nipër, letë mësonjënë më përpara shtëpin' e tyre të kenë besë të-mirë, edhe t'u apënë çpajime prindërvet *të tyre*; sepse këjo është e-mirë
- 3 edhe e-pëlpyerë përpara Perëndisë. Edhe ajo

që është me të-vërtetë e-ve edhe *ka mbeturë*
 e vetëmë shpren mbë Perëndinë, edhe qëndron
 ndë të-luturat e ndë të-falurat nat' e ditë;
 6 Po ajo që prish shumë për dëfrime, ndo-
 7 nëse rron, ka vdekurë. Edhe këto porosit, që
 8 të mos zihenë gojë për të-liga. Po ndë qoftë
 se ndonjë nukë mendonët më përpara për
 të-titë, edhe më fort për ata të shtëpis' së
 ti, ky ka mohuarë besënë, edhe është më-lik
 se i-pabesi.

9 E-ve më pak se gjashtë-dhjetë vjeç letë
 mos vihetë ndë numërët të të-vavet, edhe të
 10 ketë qënë grua e një burri, Edhe të ketë
 dëshmim për punëra të-mira; ndë ka rriturë
 fëmijë, ndë ka priturë të-huaj, ndë ka larë
 këmbë shënjtorësh, ndë u ka ndihurë aty-
 reve që kanë qënë ndë shtrëngim, ndë ka
 11 rënë prapa çdo farë pune së-mirë. Po hiq dorë
 nga të-vatë më të-ra; sepse si të mërzitenë nga
 12 Krishti, duanë të-martonenë; Dyke pasurë
 dënimn' e tyre, sepse shkelnë besën e-parë.
 13 Edhe mbë gjithatë kohë mësonenë dyke
 vaturë shtëpi mbë shtëpi të jenë përtacka;
 edhe jo vetëmë përtacka, po edhe fjalë-shu-
 ma e kërkimsore, dyke folurë ato që s' gjan
 14 të flasënë. Dua pra të-ratë të martonenë, të bë-
 njënë djem, të bënenë zonja shtëpie, të mos
 i apën' asndonjë shkak armikut për të folurë
 15 keq. Sepse ca nga ato ndashti janë kthyerë
 16 prapa Satanajt. Ndë qoftë se ndonjë besëtar

a besëtare ka *gra të-va*, let' u apënë atyre
 të nevojshimetë, edhe letë mos ngarkonetë
 kisha, që të muntjë t' u ndihnjë atyreve që
 janë me të-vërtetë të-va.

17 Pleqtë e kishësë që shikonjënë mirë pu-
 nënë letë ndëronenë dy herë më tepërë, më
 fort ata që mundonenë me fjalë e me më-
 18 sim. Sepse shkronja thotë, „Nukë dotë mbyllç
 gojën' e kaut që shin;“ edhe, „I-vëjyerë është
 19 punëtori për pagën' e ti“. Mos prit kallëzim
 kundër plaku, veç përpara dy a tre dësh-
 20 mltarëve. Ata që fëjjenjënë qërto-i përpara
 të-gjihtëve, që të kenë frikë edhe të-tjerët.
 21 Të urdhëronj përpara Perëndisë, edhe Zotit
 Iisu Krisht, edhe ëngjëjvet të-sgjedhurë, t'i
 ruanj këto pa bërë të-çquarë ndë mest nje-
 riu e njeriu, e asgjë të mos bëjnij me të-mbaj-
 turë anë.

22 Mos vërë duar me të-çpejtë as mbi ndo-
 një, as mos ubëj pjesëtar ndër faje të-huaj;
 23 ruaj vetëhenë t'ënde të-qëruarë. Mos pi më
 ujë, po përdor pakëzë verë për stomakunë
 t'ënt e për sëmundjet' e tua të-dëndura.

24 Ca njerësve fajetë u dukenë faqeza, edhe
 shkonjënë përpara atyreve ndë gjyq; po ca
 25 të-tjerëve u venë prapa. Gjithashtu edhe pu-
 nërat' e-mira janë të-çfaqura; edhe ato që
 janë tjetrazi nukë munt të fshihenë.

Krye 6.

- 1 Sa janë robër ndënë sqjedhë, let' i numëronjënë zotërinj' e tyre të-vëjyerë për çdo farë nderi, që të mos shahetë emër' i Perëndisë
- 2 edhe mësimi. Edhe ata që kanë zotërinj besëtarë, letë mos i bënë për asgjë, sepse janë vëllezër; po më shumë let' u punonjënë, sepse janë besëtarë edhe të-dashurë ata që shohënë dobi nga pun' e atyre e-mirë. Këto mëso edhe këshillo.
- 3 Edhe ndë mëson ndonjë mësimë të-tjerë, edhe nukë vetë pas fjalëvet të-shëndosha të Zotit t'ënë Jisu Krisht, edhe pas mësimi që
- 4 është pas besës' së-mirë, Ky është madhështuar, edhe nukë di asgjë, po vuan prej sëmundjeje për çështje e për të-ngrëna me fjalë, prej të-cilavet del çmir, qartë, të-shara,
- 5 mendime të-liq, Fjalime të-kotë të-njerësve të-prishurë nga mëndja, edhe të-cilëvet u shteret' e-vërteta, sepse pandehnjënë, se bes' e-mirë është për fitim. Mërgohu nga të-tillët.
- 6 Po fitim i-math është bes'e-mirë me mbastim
- 7 mbë të-pakët. Sepse as gjë s'kemi prurë ndë botët; edhe është e-ç'faqurë se edhe të nxjerimë
- 8 gjë nukë mundimë. Po kur kemi ushqime e
- 9 të-mbuluara, letë na mbastonjënë këto. Po ata që duanë të bënenë të-pasurë, bjenë ndë ngasje edhe ndë lak, edhe ndë shumë dëshërimi të-marrë e të-dëçmim, të-cilëtë i kredhënë

- 10 njerëzitë ndë prishje e ndë humbje. Sepse rrënja e gjithë të-ligavet është ergjëndashja; të-cilënë ca dyke dëshëruarë uaratisë nga besa, edhe e depërtuanë vetëhen' e tyre me shumë të-këqia.
- 11 Po ti, o njeriu i Perëndisë, hiq dorë nga këto; edhe ndiq drejtëri, të-ndrojturë nga Perëndia, besë, dashuri, durim, butësi. Luftë luftën' e-mirë të besësë, rrok jetën' e përjetëshme, ndë të-cilët edhe uthirrë, edhe rrëfeve rrëfimin' e mirë përpara shumë dëshmim-
- 13 tarëve. Të porosit përpara Perëndisë që u ep jetë të-gjithave, edhe përpara Jisu Krishtit që dëshmoj ndë ditët të Pont Pillatit
- 14 rrëfimin' e-mirë, Të ruanjç porosinë të-pafë-likurë, pa palavi, gjer mbë të-dukurit të Zoti t'ënë Jisu Krisht, Të cilëtë ndë kohë të-urdhëruara dot' a dëftenjë i-lumuri edhe i-vetëmi Fuqitar, Mbreti i atyreve që mbretëro-
- 16 njënë edhe Zoti i atyre që zotëronjënë, Ay që i-vetëmë ka pavdekje, edhe që rri ndë dritë të-paafëruarshime, të-cilinë asndonjë nga njerëzitë nuk' e pa, as munt t'a shohë; mbë të-cilinë qoftë nder e pushtet i-përjetëshm. Amin.
- 17 Të-pasuritë ndë këtë jetë porosit-i të mos mbahenë mbë të-math, as të mos shprenjënë ndë pasjet që s'qëndron ndë një vënt, po mbë Perëndinë e gjallë, i-cili na ep të-gjitha dorë-
- 18 hapurë për të parë dobi; Të punonjënë pu-

nëra të-mira, të bënenë të pasurë ndë punëra të-mira, të jenë dorë-dhënës, të-shoqëruar-
19 shim, Dyke vënë *kështu* me pasje të-madhe për vetëhen' e tyre një themeli për të-pritmenë, që të arrinjënë jetën' e-përjetëshme.

20 O Timothe, ruaj ndorjenë, dyke ularguarë nga të-ndyratë fjalë të-kota, edhe nga kundrë-fjalët' e diturisë që mbë të-rrem qu-
21 hetë *kështu*; Të-cilënë ca dyke pasurë për mjeshtëri ranë jashtë nga besa.— Hiri qoftë me ty. Amin.
